



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË

Nr. 3221/5 prot.

Rrogozhinë, më 03.09.2026

LËNDA: PËRMBLEDHJE E REKOMANDIMEVE TË DALA NGA DËGJESAT PËR DRAFTIN E REFORMËS ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE 2.0 NË BASHKINË RROGOZHINË

DREJTUAR : KËSHILLIT BASHKIAK RROGOZHINË

PËR DIJENI : N/KRYETAR I BASHKISË USHTRUES I DETYRËS SË KRYETARIT
Andi PROSHKA

I. Qëllimi

Ky dokument paraqet një përmbledhje të mendimeve, shqetësimeve, propozimeve dhe rekomandimeve të shprehura nga banorët, përfaqësuesit e komunitetit dhe grupet e interesit gjatë dëgjësive publike të zhvilluara në kuadër të konsultimit publik për draftin e Reformës Administrativo-Territoriale 2.0.

Më poshtë pasqyrohen çështjet e ngritura gjatë dëgjësive dhe synojnë t'i përcillen Këshillit Bashkiak Rrogozhinë për t'u marrë në konsideratë në kuadër të konsultimit publik.

II. Përmbledhje e konsultimeve publike sipas njësive administrative

1. Njësia Administrative Kryevidh

Gjatë dëgjësës publike në Njësinë Administrative Kryevidh

Të pranishmit shprehën kundërshtimin e tyre ndaj Reformës Administrativo-Territoriale dhe veçanërisht ndaj propozimit për bashkimin e Bashkisë Rrogozhinë me Bashkinë Kavajë. U ngritën shqetësime lidhur me ndikimin që një bashkim i tillë mund të ketë në mundësitë e punësimit dhe në rritjen e emigrimit të të rinjve nga zona.

Në përfundim, të pranishmit mbështetën vijimin e përkatësisë së Njesisë Administrative Kryevidh në Bashkinë Rrogozhinë dhe garantimin e marrjes së shërbimeve administrative pranë saj.

2. Njësia Administrative Lekaj

Të pranishmit shprehën kundërshtimin e tyre ndaj propozimit për bashkimin e Bashkisë Rrogozhinë me Bashkinë Kavajë, duke ngritur shqetësime lidhur me mënyrën e funksionimit dhe administrimit të Njesisë Administrative Lekaj pas një bashkimi të mundshëm, si dhe me garantimin e trajtimit dhe zgjidhjes së problematikave të zonës.

Gjithashtu, u theksua rëndësia e marrjes në konsideratë të mendimit dhe vullnetit të qytetarëve gjatë procesit të Reformës Administrativo-Territoriale, duke kërkuar një proces sa më transparent dhe gjithëpërfshirës.

3. Njësia Administrative Gosë

Administratori i Njesisë Administrative Gosë u shpreh kundër Reformës Administrativo-Territoriale, duke theksuar shqetësimet që një riorganizim i mundshëm do të sillte për komunitetin. Të pranishmit kërkuar një përfshirje më të madhe të qytetarëve në proceset vendimmarrëse dhe theksuan vështirësitë që mund të krijoheshin në aksesimin e shërbimeve në Bashkinë Kavajë, veçanërisht për qytetarët me mundësi të kufizuara ekonomike dhe transporti.

Gjithashtu, u nënvizua rëndësia e ruajtjes dhe zhvillimit të potencialit kulturor të Rrogozhinës, si dhe forcimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe komunitetit.

Në përfundim, të pranishmit shprehën kundërshtimin e tyre ndaj bashkimit të Bashkisë Rrogozhinë me Bashkinë Kavajë dhe kërkuar që vullneti i komunitetit të merret në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes.

4. Bashkia Rrogozhinë dhe Njësia Administrative Sinaballaj

Gjatë zhvillimit të dëgjësës publike, të pranishmit shprehën qëndrimin e tyre kundër shkrirjes së Bashkisë Rrogozhinë dhe bashkimit të saj me Bashkinë Kavajë. Pjesëmarrësit theksuan rëndësinë e ruajtjes së Bashkisë Rrogozhinë si një njësi administrative me identitetin, specifikat, interesat dhe potencialin e saj të veçantë për zhvillim ekonomik dhe social.

Një ndër shqetësimet kryesore të ngritura lidhej me pasojat që një bashkim i mundshëm administrativ do të mund të sillte për qytetarët, veçanërisht për sa i përket aksesit në shërbimet publike. U theksua se distanca ndërmjet territorit të Bashkisë Rrogozhinë dhe Bashkisë Kavajë, e shoqëruar me mungesën ose pamjaftueshmërinë e transportit publik, mund të krijonte vështirësi të konsiderueshme për qytetarët, veçanërisht për banorët e njësive administrative dhe zonave më të largëta. Sipas të pranishmëve, një riorganizim i tillë nuk duhet të sjellë rritje të kostove dhe vështirësi në aksesimin e shërbimeve administrative.

Gjithashtu, pjesëmarrësit kërkuar që çdo vendimmarrje në kuadër të Reformës Administrative-Territoriale 2.0 të mbështetet në konsultim të gjerë dhe real me komunitetin. U nënvizua nevoja që vullneti dhe qëndrimi i qytetarëve të merren në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes, duke garantuar transparencë, përfshirje dhe komunikim të vazhdueshëm me komunitetin.

Në diskutime u evidentua gjithashtu rëndësia e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve vendore dhe komunitetit, me qëllim që çdo ndryshim i mundshëm territorial dhe administrativ të vlerësohet në funksion të interesit publik, aksesit në shërbime dhe zhvillimit të qëndrueshëm të zonës.

Në përfundim, të pranishmit kërkuar që Bashkia Rrogozhinë të vijojë të funksionojë si njësi administrative më vete, duke ruajtur identitetin dhe autonominë e saj administrative, si dhe duke garantuar mbrojtjen e interesave të banorëve të saj. U theksua se çdo ndryshim i mundshëm duhet të jetë rezultat i një procesi të argumentuar, transparent dhe gjithëpërfshirës, ku zëri dhe vullneti i komunitetit të kenë një rol të rëndësishëm në vendimmarrje.

III. Rekomandime të përgjithshme

Nga dëgjesat publike rezulton nevoja që, në vijim të procesit të konsultimit, të merren në konsideratë:

- Të merret në konsideratë vullneti dhe qëndrimi i qytetarëve në procesin e Reformës Administrativo-Territoriale 2.0.
- Të ruhet Bashkia Rrogozhinë si njësi administrative më vete, duke marrë në konsideratë identitetin, interesat dhe potencialin e saj zhvillimor.
- Të garantohet akses i lehtë dhe i barabartë në shërbimet publike, veçanërisht për banorët e njësive administrative dhe qytetarët me vështirësi ekonomike apo transporti.
- Të forcohet përfshirja e komunitetit dhe transparenca në proceset vendimmarrëse.
- Të mbështetet zhvillimi kulturor, ekonomik dhe social i Rrogozhinës, si dhe forcimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe komunitetit.
- Të shmanget një riorganizim administrativ që mund të sjellë vështirësi në administrim, punësim dhe ofrimin e shërbimeve për komunitetin.

Konc:

Koordinatorë e njoftimit dhe Konsultimit Publik Kamela Shala



Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

N/KRYETAR I BASHKISË
USHTRUES I DETYRËS SË KRYETARIT
Andi PROSHKA

